

VENDIM
Nr. 301, datë 19.5.2021

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
TURIZMIT DHE MJEDISIT, TË PRONËS SË PALUAJTSHME, ME SIPËRFAQE
PREJ 10 000 m², E LLOJIT TRUALL, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8561,
ME NUMËR PASURIE 1/911, NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13, 14 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe prej 10 000 (dhjetë mijë) m², e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim përdorimin e saj për zhvillimin e projekteve të investimit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Sipërfaqja prej 10 000 (dhjetë mijë) m², e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Korçë.

3. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës të paluajtshme, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

HARTA TREGUESE REGJISTRIMIT (Fragment)

DREJTORIA VENDORE E ASHK
KORÇË

DREJTOR

Nada BANDILLI



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

Z.KADASTRALE 2561 NR PASURIE 11911 Vol 55 Fq 49

INDEKSI HARTES KO-J-9 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi KORÇE Q/F KORÇE

Rr/L P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

C. PRONARET

V. 11912

L. 11912, X

BASHKRIA KORÇE

J. 11912

P. 11912

D.Data: 17.15.2013

Ora

